

BANKA E SHQIPËRISË

B U L E T I N I
Z Y R T A R

vëllimi 17 numër 8 dhjetor 2015

Data e botimit 24.12.2015

P Ë R M B A J T J A

1. Licencë nr. 35, datë 16.11.2015 "Për të vepruar si institucion i parasë elektronike në Republikën e Shqipërisë"	4
2. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 90, datë 2.12.2015 "Për miratimin e Statutit të Bankës së Shqipërisë"	6
3. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 91, datë 2.12.2015 "Për disa ndryshime në rregulloren "Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit"	17
4. Urdhër nr. prot. 6169, datë 10.12.2015 "Për dhënien e miratimit paraprak për ushtrimin e veprimtarisë financiare shtesë nga subjekti financiar jobankë FINAL sh.a."	22
5. Urdhër nr. prot. 6195, datë 14.12.2015 "Për dhënien e miratimit paraprak për ushtrimin e veprimtarisë financiare shtesë nga subjekti financiar jobankë TIRANA FACTORING & LEASE sh.a."	23
6. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 94, datë 16.12.2015 "Për mbajtjen e pandryshuar të normës së interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjella të riblerjes"	24
7. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 95, datë 16.12.2015 "Për dhënien e miratimit paraprak për kryerjen e veprimtarisë shtesë nga Banka NBG Albania sh.a."	25
8. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 97, datë 16.12. 2015 "Për dhënien e miratimit paraprak për bashkimin me përthithje të Bankës Credins sh.a. me subjektin financiar jobankë Credins Leasing sh.a."	26
9. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 98, datë 16.12.2015 "Për lirimin nga detyra të Drejtorit të Departamentit të Stabilitetit Financiar dhe Statistikave dhe emërimin e Drejtorit të Departamentit të Stabilitetit Financiar"	27
10. Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar, vëllimi 17, numër 1, mars 2015	28
11. Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar, vëllimi 17, numër 2, prill 2015	28
12. Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar, vëllimi 17, numër 3, maj 2015	29
13. Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar, vëllimi 17, numër 4, qershor 2015	30
14. Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar, vëllimi 17, numër 5, gusht 2015	30
15. Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar, vëllimi 17, numër 6, shtator 2015	31
16. Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar, vëllimi 17, numër 7, nëntor 2015	32



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË

LICENCË
NR. 35, DATË 16.11.2015

PËR TË VEPRUAR SI INSTITUCION I PARASË
ELEKTRONIKE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në mbështetje të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar, si dhe të rregullores "Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë nga subjektet financiare jobanka", miratuar me vendimin nr. 01, datë 17.01.2013 të Këshillit Mbikëqyrës, Banka e Shqipërisë i jep shoqërisë "EASYPAY" sh.p.k. licencën si institucion i parasë elektronike, për të ushtruar veprimtaritë financiare të përkrahura në aneksin bashkëlidhur.

Licenca është e pakufizuar në kohë dhe nuk është e transferueshme ose e tjetërsueshme.

NATASHA AHMETAJ

ZËVENDËSGUVERNATORE E DYTË



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË

Tiranë më 16.11.2015

ANEKS

LICENCA NR. 35

VEPRIMTARITË E LEJUESHME PËR "EASYPAY" SH.P.K.

Institucioni i Parasë Elektronike "EASYPAY" Sh.p.k., në bazë të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe të rregullores "Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë nga subjektet financiare jobanka", miratuar me vendimin nr. 01, datë 17.01.2013 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë është licencuar të kryejë veprimtarinë financiare të emetimit të parasë elektronike, si dhe veprimtarinë e mëposhtme:

1. Të gjitha shërbimet e pagesave dhe të transferimit të parave.

NATASHA AHMETAJ

ZËVENDËSGUVERNATORE E DYTË



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS

VENDIM

NR. 90, DATË 2.12.2015

PËR
MIRATIMIN E STATUTIT TË BANKËS SË SHQIPËRISË

Në bazë dhe për zbatim të nenit 43, shkronja "f" të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar, me propozim të Guvernatorit, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë Statutin e Bankës së Shqipërisë sipas tekstit bashkëlidhur.
2. Ngarkohen të gjitha strukturat organizative të Bankës së Shqipërisë me zbatimin e Statutit.
3. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohet vendimi i Këshillit Mbikëqyrës nr. 100, datë 19.12.2000, i ndryshuar "Për miratimin e Statutit të Bankës së Shqipërisë".
4. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Publikun me publikimin e Statutit në Buletinin Zyrtar dhe në faqen zyrtare të internetit të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI

KRYETARI

ELVIS ÇIBUKU

GENT SEJKO

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1 Statusi

1. Banka e Shqipërisë, e referuar në vijim si Banka, është Banka Qendrore e Republikës së Shqipërisë.
2. Banka është person juridik publik me pavarësi administrative dhe financiare.
3. Banka e ka selinë kryesore në Sheshin "Skënderbej" nr. 1, Tiranë.
4. Banka është autonome dhe e pavarur në përmbushjen e objektivave dhe detyrave të saj në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe me ligjin nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar, i cili referohet në vijim si Ligji.

Neni 2 Stema dhe vula

1. Stema e Bankës është Stema e Republikës së Shqipërisë.
2. Banka, në rastet e komunikimeve jozyrtare me të tretë (në botime të ndryshme, në reklama, konferenca, etj.), mund të përdorë si paraqitje vizuale përveç stemës zyrtare edhe logo të personalizuar, e cila miratohet nga Këshilli Mbikëqyrës.
3. Vula e Bankës është rrethore, në qendër ka Stemën e Republikës së Shqipërisë (me të gjithë elementët përbërës të saj, në përputhje me kërkesat e ligjit "Për formën dhe përmasat e flamurit kombëtar, përmbajtjen e himnit kombëtar, formën dhe përmasat e Stemës së Republikës së Shqipërisë dhe mënyrën e përdorimit të tyre") dhe emrin: "Banka e Shqipërisë".
4. Në Bankë, përveç vulës zyrtare, mund të përdoren dhe vula të tjera të zakonshme të cilat përfaqësojnë struktura të caktuara të Bankës (si për shembull: vula datare). Forma, lloji, karakteristikat dhe mënyra e përdorimit e vulave të tjera të zakonshme përcaktohet me akt të veçantë të Këshillit Mbikëqyrës.

Neni 3 Kapitali

1. Kapitali i Bankës është 2.5 miliardë lekë.
2. Kapitali është në pronësi ekskluzive të Shtetit Shqiptar dhe nuk mund të transferohet apo të vendoset si garanci.

3. Kapitali i Bankës mund të rritet me propozim të Bankës dhe me miratimin e Ministrisë së Financave.

KREU II OBJEKTIVAT DHE DETYRAT

Neni 4 Objektivat

1. Objektivi kryesor i Bankës është arritja dhe ruajtja e stabilitetit të çmimeve.
2. Banka, në përputhje me, dhe në mbështetje të objektivit kryesor të saj, realizon edhe objektivat e tjerë të përcaktuar në nenin 3 të Ligjit, duke përfshirë realizimin e politikës monetare, administrimin e kartëmonedhave dhe të monedhave me kurs ligjor, përcaktimin dhe zbatimin e regjimit të kursit të këmbimit, stabilitetin e sistemit financiar dhe të infrastrukturës së tij.

Neni 5 Detyrat

Në përmbushje të objektivave të saj, detyrat kryesore të Bankës janë:

- a) të jetë emetuesi i vetëm i kartëmonedhave dhe monedhave kombëtare me kurs ligjor në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe të përcaktojë prerjen, formën, peshën, modelin dhe karakteristikat e tjera të kartëmonedhave dhe monedhave me kurs ligjor, si dhe kartëmonedhave dhe monedhave të cilat emetohen për qëllime numizmatike;
- b) të hartojë planin e emetimit dhe të sigurojë furnizimin e rregullt me kartëmonedha dhe monedha me qëllim përmbushjen e kërkesave të ekonomisë për para;
- c) të hartojë, të miratojë dhe të zbatojë politikën monetare të Republikës së Shqipërisë në mënyrë të pavarur, në përputhje me objektivin e saj kryesor;
- d) të hartojë, të miratojë dhe të zbatojë regjimin e këmbimit valutor dhe politikën e kursit të këmbimit të valutave në Republikën e Shqipërisë;
- e) të licencojë, të mbikëqyrë dhe të rregullojë veprimtarinë bankare dhe financiare të ushtruar nga bankat dhe degët e bankave të huaja, me qëllim që të sigurojë stabilitetin e sistemit bankar;
- f) të licencojë, të mbikëqyrë dhe të rregullojë subjektet financiare jobankare;
- g) të zhvillojë metodologjitë përkatëse dhe të përcaktojë instrumentet e nevojshme për vlerësimin dhe administrimin e rrezikut sistemik në sistemin financiar, duke u mbështetur për këtë qëllim në bashkëpunimin me institucionet relevante, vendase dhe të huaja;

- h) të mbajë dhe të administrojë rezervat valutore;
- i) të veprorë në cilësinë e bankierit, këshilltarit dhe agjentit fiskal të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë;
- j) të nxisë funksionimin normal të sistemit të pagesave;
- k) të organizojë ankandet e titujve në emër të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, si dhe mund të emetojë tituj në emër të vetë Bankës;
- l) të mbikëqyrë pagesat ndërkombëtare, të cilat rrjedhin nga aktiviteti tregtar dhe jotregtar me jashtë, si dhe nga veprimet e bankave të licencuara në Shqipëri në zbatim të kontratave me shtete, banka apo kompani të huaja;
- m) të zhvillojë dhe të organizojë instrumentet e nevojshme, si dhe të mbështesë bashkëpunimin ndërinstitucional, me qëllim ndërtimin e sistemeve përkatëse të statistikave për hartimin e bilancit të pagesave të shtetit shqiptar, për plotësimin e statistikave monetare dhe financiare;
- n) të licencojë, të mbikëqyrë dhe të rregullojë agjentët e këmbimit valutor; dhe
- o) detyra të tjera të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.

KREU III DREJTIMI DHE ORGANIZIMI

Neni 6 Pavarësia

Në përputhje me nenin 1 të Ligjit, gjatë përmbushjes së objektivave dhe ushtrimit të detyrave, Banka është e pavarur dhe transparente në procesin vendimmarrës dhe nuk merr instruksione nga asnjë institucion, entitet apo organ tjetër publik apo privat. Të gjitha subjektet duhet të kujdesen të respektojnë këtë parim dhe të mos kërkojnë të influencojnë anëtarët e organeve vendimmarrëse të Bankës gjatë përmbushjes së detyrave të tyre.

Neni 7 Organizimi

1. Banka organizohet në mënyrë hierarkike dhe të qendëruar, me seli në Tiranë dhe degë në qendra administrative brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.
2. Organizimi strukturor do të udhëhiqet nga parimet e funksionalitetit dhe të eficiencës.
3. Veprimtaria e Bankës organizohet nëpërmjet njësive organizative në përputhje me strukturën organizative të miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës.
4. Struktura organizative e Bankës përbëhet nga:

- a) Administrata në qendër, e cila përbëhet nga:
 - i. Guvernatori;
 - ii. Zëvendësguvernatori i Parë;
 - iii. Zëvendësguvernatori i Dytë;
 - iv. Inspektori i Përgjithshëm;
 - v. Departamentet;
 - vi. Kabineti i Guvernatorit.
 - b) Administrata lokale, e cila përbëhet nga degët e Bankës.
5. Banka, me vendim të Këshillit Mbikëqyrës mund të hapë filiale, degë ose agjenci brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë.

Neni 8 Organet drejtuese

Banka drejtohet nga Këshilli Mbikëqyrës, që është organi më i lartë vendimmarrës dhe mbikëqyrës, dhe nga administratorët, që janë guvernatori, i cili kryeson Këshillin dhe dy zëvendësguvernatorët.

Neni 9 Përbërja dhe emërimi i anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës

1. Këshilli Mbikëqyrës përbëhet nga 9 (nëntë) anëtarë, si vijon:
 - a) Guvernatori, i cili është Kryetar i Këshillit Mbikëqyrës;
 - b) Zëvendësguvernatori i Parë, i cili është Zëvendëskryetar i Këshillit;
 - c) Zëvendësguvernatori i Dytë; dhe
 - d) Gjashtë anëtarë të tjerë.
2. Të gjithë anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës emërohen nga Kuvendi (bazuar në propozimet e organeve të përcaktuara në nenin 44 të Ligjit) për një mandat 7 (shtatë) vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje.

Neni 10 Kompetencat e Këshillit Mbikëqyrës

1. Këshilli Mbikëqyrës është organi më i lartë vendimmarrës dhe mbikëqyrës i politikave, i administrimit dhe i operacioneve të Bankës.
2. Këshilli Mbikëqyrës ushtron në përgjithësi kompetencat e përcaktuara në nenin 43 të Ligjit dhe në veçanti kompetenca të tjera të përcaktuara në dispozita të tjera të Ligjit, në ligje të tjera ose në këtë statut.
3. Këshilli Mbikëqyrës asistohet nga Sekretari, i cili emërohet prej tij ndërmjet stafit drejtues të Bankës dhe nuk është anëtar i Këshillit.

4. Këshilli Mbikëqyrës, me propozim të Guvernatorit mund të vendosë për krijimin e komiteteve për çështje specifike të një natyre të veçantë. Komitetet janë organe kolegjiale vendimmarrëse ose këshillimore.
5. Këshilli Mbikëqyrës në ushtrimin e kompetencave të tij miraton vendime, rregullore dhe udhëzime me zbatim të përgjithshëm. Ai mund të adresojë rekomandime dhe/ose opinione për çështje të caktuara.
6. Rregullat e funksionimit të Këshillit Mbikëqyrës përcaktohen në rregullore të veçantë të miratuar prej tij.

Neni 11 Guvernatori

1. Guvernatori është Kryetari i Këshillit dhe vepron si drejtor i përgjithshëm ekzekutiv i Bankës, i ngarkuar me mbarëvajtjen e veprimtarisë së përditshme të Bankës.
2. Guvernatori, në përgjithësi, ushtron të gjitha kompetencat që nuk i njihen nga Ligji shprehimisht Këshillit Mbikëqyrës, dhe në veçanti ato kompetenca që ia cakton shprehimisht Ligji apo aktet nënligjore të Këshillit Mbikëqyrës.
3. Në rast se Guvernatori mungon ose është në pamundësi për të vepruar, kompetencat e tij ushtrohen nga Zëvendësguvernatori i Parë i Bankës.
4. Guvernatori është përgjegjës në mënyrë të drejtpërdrejtë për mbarëvajtjen e veprimtarisë së departamenteve që ka në varësi, sipas përcaktimeve në rregulloret e brendshme të departamenteve dhe të strukturës organizative, të miratuara nga Këshilli Mbikëqyrës.
5. Guvernatori përfaqëson ligjërisht Bankën në të gjitha marrëdhëniet me palët e treta, me përjashtim të rasteve kur këtë të drejtë e delegon tek nëpunës të tjerë, pas miratimit të Këshillit Mbikëqyrës.
6. Guvernatori në ushtrimin e kompetencave të tij nxjerr vendime, urdhra me karakter të posaçëm, udhëzime, rekomandime dhe opinione në zbatim të Ligjit, si dhe akteve nënligjore të Këshillit Mbikëqyrës.

Neni 12 Zëvendësguvernatorët

1. Zëvendësguvernatori i Parë dhe Zëvendësguvernatori i Dytë asistojnë Guvernatorin në ushtrimin e kompetencave të tij, duke kontribuar secili brenda kompetencave përkatëse të caktuara nga Këshilli Mbikëqyrës sipas pikës 2 të këtij neni.

2. Zëvendësgubernatorët janë përgjegjës në mënyrë të drejtpërdrejtë për mbarëvajtjen e veprimtarisë së departamenteve që kanë në varësi, sipas përcaktimeve në rregulloret e brendshme të departamenteve dhe të strukturës organizative, të miratuara nga Këshilli Mbikëqyrës.
3. Zëvendësgubernatori i Parë, vepron si drejtues i përgjithshëm ekzekutiv i Bankës në mungesë dhe në pamundësi për të vepruar të Guvernatorit.
4. Në rast se një nga Zëvendësgubernatorët mungon ose është në pamundësi për të ushtruar kompetencat, Zëvendësgubernatori tjetër merr dhe ushtron kompetencat e tij.
5. Zëvendësgubernatorët në ushtrimin e kompetencave të tyre, nxjerrin vendime, urdhra me karakter të posaçëm, udhëzime, rekomandime dhe opinione në zbatim të Ligjit, si dhe akteve nënligjore të Këshillit Mbikëqyrës.

Neni 13 Inspektori i Përgjithshëm

1. Inspektori i Përgjithshëm emërohet nga Kuvendi për një afat 5 (pesë) vjeçar dhe drejton Departamentin e Kontrollit në Bankë.
2. Inspektori i Përgjithshëm dhe inspektorët e Departamentit të Kontrollit, të emëruar nga Guvernatori bazuar në propozimin e Inspektorit të Përgjithshëm, përmbushin detyrat e tyre në përputhje me Ligjin, rregulloren e brendshme të departamentit, politikën e auditimit të brendshëm, me standardet ndërkombëtare për praktikën profesionale të auditimit të brendshëm, me Kodin e Etikës të Institutit të Audituesve të Brendshëm (IAB) dhe akte të tjera të fushës.

Neni 14 Departamentet

1. Departamentet janë njësi organizative të Bankës që ushtrojnë veprimtarinë e tyre sipas rregulloreve të brendshme të organizimit dhe funksionimit të tyre të miratuara nga Këshilli Mbikëqyrës.
2. Departamentet e Bankës klasifikohen si vijon:
 - a) departamente me funksione kryesore;
 - b) departamente me funksione dytësore;
 - c) departamente me funksione ndihmëse.

Klasifikimi konkret i departamenteve sipas kësaj pike bëhet me akt të veçantë të miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës.

Neni 15

Drejtuesit e departamenteve

1. Drejtorët e departamenteve kryejnë aktivitetin e tyre në përputhje me Ligjin, rregulloret e departamenteve dhe akteve nënligjore të miratuara nga Këshilli Mbikëqyrës dhe administratorët e Bankës.
2. Çdo drejtor departamenti, në përputhje me fushën përkatëse të kompetencës, është përgjegjës për:
 - i. Hartimin e projekteve dhe studimeve;
 - ii. Organizimin dhe administrimin e punës në njësinë organizative që drejton;
 - iii. Kryerjen në kohë dhe në mënyrë efikase të detyrave dhe përgjegjësi.
3. Guvernatori, në rast të vendit të lirë të drejtuesit të departamentiit për shkak të dorëheqjes, vdekjes, pezullimit apo shkarkimit nga detyra, ose të ndonjë shkakut tjetër të ngjashëm, emëron një drejtues të ri në vendin e lirë për një periudhë jo më shumë se 6 (gjashtë) muaj, e rinovueshme vetëm një herë, deri në miratimin e këtij emërimi nga Këshilli Mbikëqyrës.

Neni 16

Degët

1. Banka kryen aktivitetin e saj edhe nëpërmjet degëve në qytete të tjera të ndryshme nga qyteti ku ndodhet selia kryesore e saj.
2. Degët janë njësi organizative në strukturën e Bankës, në varësinë e kësaj të fundit, që kryejnë aktivitete të ndryshme në emër dhe për llogari të Bankës.
3. Organizimi dhe funksionimi i degëve rregullohet me rregullore të veçantë të Këshillit Mbikëqyrës.

Neni 17

Stafi

1. Marrëdhëniet e punësimit në Bankë rregullohen nga Ligji dhe rregullorja e posaçme e miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës. Në mungesë të parashikimeve të tyre zbatohet Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë.
2. Guvernatori emëron dhe largon të gjithë punonjësit e Bankës, brenda kufijve dhe në përputhje me kushtet dhe procedurat e punësimit të përcaktuara nga Këshilli Mbikëqyrës.
3. Me përjashtim të Inspektorit të Përgjithshëm dhe të rasteve të parashikuara në nenin 15/3 të Statutit, drejtuesit e departamenteve

emërohen dhe largohen nga Guvernatori, pas miratimit nga Këshilli Mbikëqyrës.

Neni 18 Sekreti profesional

1. Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës, Administratorët, Inspektori i Përgjithshëm dhe i gjithë stafi i Bankës, edhe pas largimit nga Banka, janë të detyruar të mos bëjnë publik, gjatë gjithë kohës, asnjë informacion të mbuluar nga sekreti profesional me të cilin janë njohur gjatë ushtrimit të detyrës.
2. Personat që kanë akses në të dhëna që trajtohen si sekret profesional sipas legjislacionit të Bashkimit Evropian, janë subjekt i këtij legjislacioni.

Neni 19 Nënshkrimet

Banka, në çdo korrespondencë, përfaqësohet ligjërisht nga Guvernatori ose nga nëpunës të tjerë, sipas rregullores së posaçme të nënshkrimeve të miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës, bazuar në propozimin e Guvernatorit.

KREU IV

Neni 20 Mbajtja e pasqyrave financiare

1. Viti financiar i Bankës hapet më 1 janar dhe mbyllet më 31 dhjetor.
2. Banka, në përputhje me ligjin "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" dhe standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të kontabilitetit, përgatit pasqyrat financiare vjetore, të cilat reflektojnë gjithmonë në mënyrë të saktë operacionet dhe gjendjen financiare të Bankës.

Neni 21 Raporti Vjetor dhe pasqyrat financiare

1. Këshilli Mbikëqyrës miraton pasqyrat financiare dhe Raportin Vjetor, pjesë e të cilit është edhe opinioni i auditorit të jashtëm.
2. Raporti Vjetor, bashkë me pasqyrat financiare i paraqiten Kuvendit dhe Këshillit të Ministrave nga Guvernatori i Bankës, jo më vonë se 3 (tre) muaj nga mbyllja e vitit financiar.
3. Raporti Vjetor dhe pasqyrat financiare publikohen në formën e përcaktuar nga Këshilli Mbikëqyrës, pas miratimit të tyre.

Neni 22 Komiteti i Auditit

1. Komiteti i Auditit është një organ kolegjal joekzekutiv i Bankës, i cili krijohet me vendim të posaçëm të Këshillit Mbikëqyrës.
2. Komiteti përbëhet nga 3 (tre) anëtarë të Këshillit Mbikëqyrës, të emëruar prej tij, për një periudhë trevjeçare, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë. Administratorët e Bankës nuk mund të jenë anëtarë të Komitetit. Kryetari i Komitetit zgjidhet prej anëtarëve.
3. Komiteti ka mandat të ndihmojë në përforcimin e linjave të kontrollit të brendshëm dhe të jashtëm, në funksion të përmirësimit të vendimmarrjes së Këshillit Mbikëqyrës dhe administratorëve të Bankës.
4. Komiteti shqyrton pasqyrat financiare në përputhje me opinionin e auditorit të jashtëm nëse ato janë hartuar sipas Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (*International Financial Reporting Standards / IFRS*).
5. Funksionimi i Komitetit të Auditit përcaktohet me rregullore të veçantë të miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës.

Neni 23 Auditori i jashtëm

1. Pasqyrat financiare të Bankës auditohen nga auditorë (kontrollorë) të jashtëm, të pavarur dhe të njohur ndërkombëtarisht, të miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës.
2. Auditorët e jashtëm shprehin opinionet e tyre nëse pasqyrat financiare paraqesin një pamje të plotë dhe të drejtë të situatës financiare të Bankës në përputhje me standardet përkatëse të raportimit financiar.
3. Auditorët e jashtëm kanë të drejtë të kontrollojnë të gjithë librat dhe llogaritë e Bankës me qëllim që të marrin informacion të plotë për të gjitha transaksionet e kryera.

Neni 24 Buxheti

1. Banka përgatit buxhetin vjetor, i cili miratohet nga Këshilli Mbikëqyrës përpara fillimit të çdo viti financiar.
2. Mënyra dhe procedurat e hartimit të buxhetit vjetor përcaktohen me akt të veçantë të miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës.

KREU V DISPOZITA TË VEÇANTA

Neni 25 Konflikti i interesave

Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës dhe stafi i Bankës shmangin kryerjen e çdo veprimi apo mosveprimi, që mund të përbëjë interes për subjektet e rregulluara dhe të mbikëqyrura nga Banka apo për palë të treta me të cilat Banka ka marrëdhënie. Në çdo rast, ata veprojnë në përputhje me Kodin e Etikës të miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës.

Neni 26 Prokurimet

Këshilli Mbikëqyrës miraton akte me karakter të përgjithshëm ose të veçantë për procedurat e prokurimit në përputhje me parimet e transparencës, publikimit, konkurrencës, barazisë, mosdiskriminimit dhe administrimit eficient të mjeteve financiare të Bankës.

KREU VI DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 27 Shfuqizime

Me hyrjen në fuqi të këtij Statuti, shfuqizohet Statuti i Bankës i miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr.100, datë 19.12.2000, i ndryshuar.

Neni 28 Publikimi

Statuti publikohet në Buletinin Zyrtar të Bankës dhe në faqen zyrtare të internetit të Bankës.

Neni 29 Hyrja në fuqi

Statuti hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I KËSHILLIT MBIKËQYRËS

GENT SEJKO



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS

VENDIM

NR. 91, DATË 2.12.2015

PËR
DISA NDRYSHIME NË RREGULLOREN "PËR RAPORTIN E
MJAFTUESHMËRISË SË KAPITALIT"

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12, shkronja "a", dhe nenit 43, shkronja "c", të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar; nenit 58, shkronjat "a", "b", "c" dhe "ç", nenit 59, pikat 2 dhe 3, dhe të nenit 60, pika 2, të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes dhe Departamentit të Stabilitetit Financiar dhe Statistikave, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Në rregulloren "Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit" miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr.48, datë 31.07.2013, të bëhen ndryshimet e mëposhtme:
 - a) Përmbajtja e nenit 6 ndryshon si më poshtë vijon:

"1. Bankat llogarisin ekspozimet e ponderuara me rrezikun, si shumë e elementëve të mëposhtëm:

 - a) zërave të ekspozimeve dhe ekspozimeve të mundshme, të ponderuar me rrezikun e kredisë dhe rrezikun e kredisë së kundërpartisë, të llogaritura sipas Metodës Standarde, të përcaktuar përkatësisht në kreun III dhe në kreun VI të kësaj rregulloreje;
 - b) kërkesës për kapital për rrezikun e tregut, të llogaritur sipas kërkesave të përcaktuara në kreun VII të kësaj rregulloreje, të shumëzuara me 12.5;
 - c) kërkesës për kapital për rrezikun operacional, të llogaritur sipas Metodës së Treguesit të Thjeshtë ose sipas Metodës Standarde, të përcaktuara në kreun VIII të kësaj rregulloreje, të shumëzuara me 12.5.

2. Pavarësisht përcaktimeve në paragrafin 1 të këtij neni, banka rregullon totalin e aktiveve dhe të zërave jashtë bilancit të ponderuar me rrezikun, siç përcaktohet më poshtë:
 - a) duke e shtuar me vlerën e rritjes që rezulton në krahasim me muajin mars 2013, të klasave në aktiv të bilancit “veprimet me thesarin dhe transaksionet ndërbankare” dhe “veprime në valutë me tituj” me jorzidentët, pasi të jetë zbritur vlera e shtuar e detyrimeve ndaj jorzidentëve në valutë që i përkasin të njëjtave klasa në atë periudhë raportuese;
 - b) për vitin 2016:
 - (i) për periudhën 1 janar – 30 qershor 2016, duke e pakësuar me vlerën që rezulton nga një prej dy llogaritjeve të mëposhtme:
 - (1.) vlerën e rritjes së tepicës bruto të kredisë për klientët¹, të akorduar brenda vendit, në periudhën e raportimit, e kthyer në bazë vjetore, në krahasim me muajin dhjetor 2015, në rast se kjo rritje është më e madhe se 4 (katër) % dhe më e vogël ose e barabartë me 10 (dhjetë) %;
 - (2.) vlerën 10 (dhjetë) % të tepicës bruto të kredisë për klientët të akorduar brenda vendit, në krahasim me muajin dhjetor 2015, në rast se rritja në periudhën e raportimit, e kthyer në bazë vjetore, është më e madhe se 10 (dhjetë) %.
 - (ii) për periudhën 1 korrik – 31 dhjetor 2016, duke e pakësuar me gjysmën e vlerës që rezulton nga një prej dy llogaritjeve të mëposhtme:
 - (1.) vlerën e rritjes së tepicës bruto të kredisë për klientët², të akorduar brenda vendit, në periudhën e raportimit, e kthyer në bazë vjetore, në krahasim me muajin dhjetor 2015, në rast se kjo rritje është më e madhe se 4 (katër) % dhe më e vogël ose e barabartë me 10 (dhjetë) %;
 - (2.) vlerën 10 (dhjetë) % të tepicës bruto të kredisë për klientët të akorduar brenda vendit, në krahasim me muajin dhjetor 2015, në rast se rritja në periudhën e raportimit, e kthyer në bazë vjetore, është më e madhe se 10 (dhjetë) %.
3. Për llogaritjet sipas përcaktimeve të shkronjave “a” dhe “b” të paragrafit 2, bëhen sipas formularit 1 dhe 2, Aneksi 8.
4. Shkronjat “a” dhe “b” të paragrafit 2 të këtij neni janë në fuqi deri në fund të vitit kalendarik 2016.

¹ Sipas Sistemit Raportues të Unifikuar, përfshihen: “Individët”, “Njësitë tregtare dhe industriale private”, “Njësitë tregtare dhe industriale publike”, “Punonjësit e bankës” dhe “Klientë të tjerë”.

² Sipas Sistemit Raportues të Unifikuar, përfshihen: “Individët”, “Njësitë tregtare dhe industriale private”, “Njësitë tregtare dhe industriale publike”, “Punonjësit e bankës” dhe “Klientë të tjerë”.

5. Në përfundim të afatit të përcaktuar në pikën 4 të këtij neni, banka respekton nivelin minimal të raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit sipas nenit 5 të kësaj rregulloreje ose përcaktimeve të tjera të Bankës së Shqipërisë.
 - a) formularët 1 dhe 2 të Aneksit 8, ndryshojnë si bashkëlidhur këtij vendimi;
 - b) në formularin 9 të Aneksit 7, rreshti i fundit ndryshon në "Pakësimet për rritjen e portofolit brenda vendit për vitin 2016".
2. Ngarkohen Departamenti i Mbikëqyrjes dhe Departamenti i Stabilitetit Financiar dhe Statistikave me ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.
3. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Publikun për publikimin e këtij vendimi në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi në datë 1 janar 2016.

SEKRETARI

ELVIS ÇIBUKU

KRYETARI

GENT SEJKO

ANEKS 8

FORMULARI I RAPORTIMIT NR. 1

Llogaritja e rritjes së totalit të aktiveve të ponderuara me rrezik, bazuar në klasat "Veprimet me thesarin dhe transaksionet ndërbankare" dhe "Veprimet me letrat me vlerë" jorezidente në valutë
(në mijë lekë)
Emri i bankës
Periodha raportuese
Data e raportimit
Përgatiti (emër, mbiemër, firmë)
Drejtuksi (emër, mbiemër, firmë)

Nr.	Llogaritja e rritjes së totalit të aktiveve të ponderuara me rrezik, bazuar në klasat "Veprimet me thesarin dhe transaksionet ndërbankare" dhe "Veprimet me letrat me vlerë", të jorezidentëve në valutë	Mënyra e llogaritjes
1.	Totali i zërave të aktivit "Veprimet me thesarin dhe transaksionet ndërbankare" dhe i "Veprimeve me letrat me vlerë" të jorezidentëve në valutë, mars 2013	(a)
2.	Totali i zërave të aktivit "Veprimet me thesarin dhe transaksionet ndërbankare" dhe i "Veprimeve me letrat me vlerë", të jorezidentëve në valutë në periudhën raportuese	(b)
3.	Rritja e zërave të aktivit "Veprimet me thesarin dhe transaksionet ndërbankare" dhe i "Veprimeve me letrat me vlerë", të jorezidentëve në valutë	(c) = (b) - (a)
4.	Totali i zërave të pasivit "Veprimet me thesarin dhe transaksionet ndërbankare" dhe i "Veprimeve me letrat me vlerë" të jorezidentëve në valutë, mars 2013	(d)
5.	Totali i zërave të pasivit "Veprimet me thesarin dhe transaksionet ndërbankare" dhe i "Veprimeve me letrat me vlerë", të jorezidentëve në valutë në periudhën raportuese	(e)
6.	Rritja e zërave të pasivit "Veprimet me thesarin dhe transaksionet ndërbankare" dhe i "Veprimeve me letrat me vlerë", të jorezidentëve në valutë	(f) = (e) - (d)
7.	Shtesa e totalit të aktiveve dhe zërave jashtë bilancit të ponderuar me rrezik	(g) = 0 nëse (c) ≤ 0 ose (c) < (f); (g) = (c) nëse (f) < 0 (g) = (c) - (f) nëse (f) > 0

FORMULARI I RAPORTIMIT NR.2

Nr.	Llogaritja e pakësimit të totalit të aktiveve dhe të zërave jashtë bilancit të ponderuar me rrezik, bazuar në rritjen e portofolit të kredisë bruto brenda vendit	Mënyra e llogaritjes
1.	Portofoli i kredisë bruto, në dhjetor 2015	(a)
2.	Portofoli i kredisë bruto, në periudhën raportuese 2016	(b)
3.	Rritja e portofolit të kredisë, 2016	(c) = (b) - (a)
4.	Rritja e portofolit të kredisë për 2016-ën, me bazë vjetore, sipas periudhës raportuese: - nëse periudha raportuese është mars 2016; - nëse periudha raportuese është qershor, 2016 - nëse periudha raportuese është shtator 2016 - nëse periudha raportuese është dhjetor 2016	(d) = (c) * 4; (d) = (c) * 2; (d) = (c) * 4/3 (d) = (c)
5.	4% e portofolit të kredisë së dhjetorit 2015	(e) = (a) * 4%
6.	10% e portofolit të kredisë së dhjetorit 2015	(f) = (a) * 10%
7.	Pakësimi i aktiveve dhe zërave jashtë bilancit të ponderuar me rrezik, vetëm mars 2016 dhe për qershor 2016	(g) = 0 nëse (d) < (e); (g) = (c) nëse (e) < (d) < (f); (g) = (f) nëse (d) > (f)
8.	Pakësimi i aktiveve dhe zërave jashtë bilancit të ponderuar me rrezik, vetëm shtator 2016 dhe për dhjetor 2016	(g) = 0 nëse (d) < (e); (g) = 50%*(c) nëse (e) < (d) < (f); (g) = 50%*(f) nëse (d) > (f)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
ZËVENDËSGUVERNATORI I DYTË

Nr. Prot. 6169
Datë: 10.12.2015

URDHËR

PËR DHËNIEN E MIRATIMIT PARAPRAK PËR USHTRIMIN E
VEPRIMTARISË FINANCIARE SHITESË NGA SUBJEKTI FINANCIAR
JOBANKË "FINAL" SH.A.

Në bazë dhe për zbatim të nenit 18 të rregullores "Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë nga subjektet financiare jobanka", miratuar me vendimin nr. 01, datë 17.01.2013 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë; dhe të pikës 5 të shtojcës nr. 3 të rregullores "Për përcaktimin e nivelit të vendimmarrjes në mbikëqyrjen e veprimtarive bankare dhe financiare", miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr.36, datë 26.05.2010, e ndryshuar, pasi u njoha me kërkesën e subjektit financiar jobankë "FINAL" sh.a. dhe bazuar në propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes,

URDHËROJ:

1. Miratimin paraprak për subjektin financiar jobankë "FINAL" sh.a, në lidhje me ushtrimin e veprimtarisë financiare shitesë për të gjitha format e kredidhënies.
2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes me ndjekjen e zbatimit të këtij urdhri.
3. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Publikun për publikimin e këtij vendimi në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

NATASHA AHMETAJ

ZËVENDËSGUVERNATORE E DYTË



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
ZËVENDËSGUVERNATORI I DYTË

Nr. Prot. 6195
Datë: 14.12.2015

URDHËR

PËR DHËNIEN E MIRATIMIT PARAPRAK PËR USHTRIMIN E
VEPRIMTARISË FINANCIARE SHITESË NGA SUBJEKTI FINANCIAR
JOBANKË "TIRANA FACTORING & LEASE" SH.A.

Në bazë dhe për zbatim të nenit 18 të rregullores "Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë nga subjektet financiare jobanka", miratuar me vendimin nr. 01, datë 17.01.2013 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë; dhe të pikës 5 të shtojcës nr. 3 të rregullores "Për përcaktimin e nivelit të vendimmarrjes në mbikëqyrjen e veprimtarive bankare dhe financiare", miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr.36, datë 26.05.2010, e ndryshuar, pasi u njoha me kërkesën e subjektit financiar jobankë "TIRANA FACTORING & LEASE" sh.a. dhe bazuar në propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes,

URDHËROJ:

1. Miratimin paraprak për subjektin financiar jobankë "TIRANA FACTORING & LEASE" sh.a, në lidhje me ushtrimin e veprimtarisë financiare shtesë të qirasë financiare.
2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes me ndjekjen e zbatimit të këtij urdhri.
3. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Publikun për publikimin e këtij vendimi në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

NATASHA AHMETAJ

ZËVENDËSGUVERNATORE E DYTË



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS

VENDIM

NR. 94, DATË 16.12.2015

PËR
MBAJTJEN E PANDRYSHUAR TË NORMËS SË INTERESIT TË
MARRËVESHJEVE TË RIBLERJES DHE TË ANASJELLA TË RIBLERJES

Në bazë dhe për zbatim të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar; me propozimin e Departamentit të Politikës Monetare, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të mbajë të pandryshuar, në nivelin 1.75 për qind, normën e interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjella të riblerjes (REPO dhe REPO të anasjella).
2. Ngarkohen Departamenti i Politikës Monetare dhe Departamenti i Operacioneve Monetare me zbatimin e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Publikun për publikimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI

ELVIS ÇIBUKU

KRYETARI

GENT SEJKO



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS

VENDIM

NR. 95, DATË 16.12.2015

PËR DHËNIEN E MIRATIMIT PARAPRAK PËR KRYERJEN E VEPRIMTARISË
SHITESË NGA BANKA NBG ALBANIA SH.A.

Në bazë të nenit 12, shkronja "a", nenit 43, shkronja "e" të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar; nenit 23, pikat 1 dhe 3, nenit 24, pika 1, shkronja "ç", dhe nenit 54 pika 2 shkronja "dh" nënpika "v" të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; si dhe rregullores "Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së bankave dhe degëve të bankave të huaja në Republikën e Shqipërisë" miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 14, datë 11.03.2009, e ndryshuar; me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të japë miratimin paraprak për kryerjen nga Banka NBG Albania sh.a. të veprimtarisë financiare shtesë, si më poshtë:
 - tregtimin për llogari të saj ose për llogari të klientëve, qoftë dhe në një këmbim valutor, në një treg të vetorganizuar (OTC) ose ndryshe të letrave me vlerë të transferueshme.
2. Autorizohet Guvernatori i Bankës së Shqipërisë të bëjë ndryshimet përkatëse në aneksin e licencës së Bankës NBG Albania sh.a., në zbatim të pikës 1 të këtij vendimi.
3. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.
4. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Publikun, për publikimin e këtij vendimi në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë, si dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI

ELVIS ÇIBUKU

KRYETARI

GENT SEJKO



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS

VENDIM

NR. 97, DATË 16.12.2015

PËR DHËNIEN E MIRATIMIT PARAPRAK PËR BASHKIMIN ME
PËRTHITHJE TË BANKËS CREDINS SH.A. ME SUBJEKTIN FINANCIAR
JOBANKË CREDINS LEASING SH.A.

Në bazë dhe për zbatim të nenit 43, shkronja "e" të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë" i ndryshuar; nenit 24, pika 1, shkronja "k" të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; dhe të rregullores "Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së bankave dhe degëve të bankave të huaja në Republikën e Shqipërisë", miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr.14, datë 11.03.2009, e ndryshuar; me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të japë miratimin paraparak për bashkimin me përthithje të Bankës Credins sh.a. (shoqëria përthithëse), me subjektin financiar jobankë Credins Leasing sh.a (shoqëria e përthithur).
2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.
3. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Publikun për publikimin e këtij vendimi në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI

KRYETARI

ELVIS ÇIBUKU

GENT SEJKO



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS

VENDIM

NR. 98, DATË 16.12.2015

PËR
LIRIMIN NGA DETYRA TË DREJTORIT TË DEPARTAMENTIT TË
STABILITETIT FINANCIAR DHE STATISTIKAVE DHE EMËRIMIN E
DREJTORIT TË DEPARTAMENTIT TË STABILITETIT FINANCIAR

Në bazë dhe për zbatim të nenit 43, shkronja "h" të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë" i ndryshuar; nenit 18 pika "b" shkronja "i", nenit 42 pika 1 të rregullores "Për marrëdhëniet e punës të personelit të Bankës së Shqipërisë", miratuar me vendimin nr.21, datë 16.05.2007 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, i ndryshuar; të vendimit të Këshillit Mbikëqyrës nr.79, datë 31.10.2005 "Për përcaktimin e strukturës organizative dhe numrin e punonjësve në organikë të Bankës së Shqipërisë" i ndryshuar; si dhe bazuar në urdhrin nr.prot.6106, datë 07.12.2015, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Miratimin e lirimit të zotit Klodion Shehu nga detyra e Drejtorit të Departamentit të Stabilitetit Financiar dhe të Statistikave të Bankës së Shqipërisë.
2. Miratimin e emërimit të zotit Klodion Shehu në detyrën e Drejtorit të Departamentit të Stabilitetit Financiar të Bankës së Shqipërisë.
3. Ngarkohet Departamenti i Burimeve Njerëzore me zbatimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Publikun me publikimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi në datën 1 janar 2016.

SEKRETARI

ELVIS ÇIBUKU

KRYETARI

GENT SEJKO

TREGUESI I LËNDËS PËR BULETININ ZYRTAR VËLLIMI 17, NUMËR 1,
MARS 2015

1. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 3, datë 28.01.2015, "Për uljen e normës së interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjella të riblerjes"
2. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 4, datë 28.01.2015, "Për miratimin e Dokumentit të Politikës Monetare"
3. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 5, datë 28.01.2015, "Për disa ndryshime në vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 15, datë 26.02.2014, "Për rishypjen e kartëmonedhave shqiptare me kurs ligjor, me prerje 1000 lekë dhe 500 lekë"
4. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 6, datë 28.01.2015, "Për miratimin e realizimit të objektit të prokurimit "Riabonimi në modulën e trajnimit për mbikëqyrjen FSISConnect" nëpërmjet një kontrate me kohëzgjatje 2-vjeçare"
5. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 7, datë 28.01.2015, "Për disa shtesa dhe ndryshime në rregulloren "Për veprimtarinë valutore"
6. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 11, datë 25.02.2015, "Për disa shtesa dhe ndryshime në rregulloren "Për marrëdhëniet e punës së personelit të Bankës së Shqipërisë" miratuar me vendimin nr. 21, datë 16.05. 2007, të Këshillit Mbikëqyrës, i ndryshuar"
7. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 12, datë 25.02.2015, "Për shfuqizimin e rregullore "Mbi rreziqet e tregut", miratuar me vendimin nr. 72, datë 02.06.1999, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, e ndryshuar"
8. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 13, datë 25.02.2015, "Për lirimin nga detyra të Drejtorit të Departamentit të Mbikëqyrjes të Bankës së Shqipërisë"
9. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 14, datë 25.02.2015, "Për lirimin nga detyra të Drejtorit të Departamentit të Administrimit të Bankës së Shqipërisë"
10. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 15, datë 25.02.2015, "Për mbajtjen e pandryshuar të normës së interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjella të riblerjes"
11. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 19, datë 04.03.2015, "Për një ndryshim në rregulloren "Për kapitalin rregullator të bankës"
12. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 20, datë 04.03.2015, "Për miratimin e disa ndryshimeve në rregulloren "Për administrimin e rrezikut nga ekspozimet e mëdha të bankave"

TREGUESI I LËNDËS PËR BULETININ ZYRTAR
VËLLIMI 17, NUMËR 2, PRILL 2015

1. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 21, datë 25.03.2015, "Për miratimin e "Pasqyrave financiare të Bankës së Shqipërisë për vitin 2014"
2. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 22, datë 25.03.2015, "Për një ndryshim në vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 37, datë

- 11.06.2008, "Për rishtypjen e monedhës metalike shqiptare me kurs ligjor, me prerje 1 lek"
3. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 23, datë 25.03.2015, "Për një ndryshim në vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 75, datë 29.10.2008, "Për rishtypjen e monedhës metalike shqiptare me kurs ligjor, me prerje 10 lek"
 4. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 25, datë 01.04.2015, "Për disa ndryshime në rregulloren "Për kërkesat minimale të publikimit të informacionit nga bankat dhe degët e bankave të huaja"
 5. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 26, datë 01.04.2015, "Për disa ndryshime në rregulloren "Për administrimin e rrezikut të kredisë nga bankat dhe degët e bankave të huaja"
 6. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 27, datë 01.04.2015, "Për miratimin e realizimit të objektivit të prokurimit "Rikonstruksioni i godinës së ish-hotel "Dajtit", nëpërmjet një kontrate me kohëzgjatje deri në 3 vjet"
 7. Licencë nr. 30, datë 27.02.2015, "Për të vepruar si subjekt financiar jobankë në Republikën e Shqipërisë"
 8. Licencë nr. 31, datë 25.03.2015, "Për të vepruar si institucion i parasë elektronike në Republikën e Shqipërisë"
 9. Licencë nr. 32, datë 31.03.2015, "Për të vepruar si institucion financiar i mikrokredisë në Republikën e Shqipërisë"

TREGUESI I LËNDËS PËR BULETININ ZYRTAR VËLLIMI 17, NUMËR 3,
MAJ 2015

1. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 29, datë 06.05.2015, "Për mbajtjen e pandryshuar të normës së interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjella të riblerjes"
2. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 33, datë 06.05.2015, "Për një ndryshim në vendimin e këshillit mbikëqyrës nr. 15, datë 26.02.2014, "Për rishtypjen e kartëmonedhave shqiptare me kurs ligjor, me prerje 500 lekë dhe 1000 lekë", i ndryshuar"
3. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 34, datë 06.05.2015, "Për disa ndryshime në rregulloren nr. 42, datë 27.06.2012, "Për transparencën dhe konfidencialitetin në Bankën e Shqipërisë"
4. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 35, datë 06.05.2015, "Për disa ndryshime në rregulloren "Për procedurat e botimeve në Bankën e Shqipërisë"
5. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 36, datë 06.05.2015, "Për "Emërimin e Zëvendësgubernatorit të Dytë të Bankës së Shqipërisë"
6. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 37, datë 06.05.2015, "Për miratimin e delegimit të kompetencës për nënshkrimin e kontratës dhe dokumentacionit operacional, në kuadër të marrëveshjes SWAP të monedhave, ndërmjet bankës së Shqipërisë dhe bankës Popullore të Kinës"
7. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 38, datë 06.05.2015, "Për caktimin e kryetarit dhe anëtarëve të Komitetit të Auditit të Bankës së Shqipërisë"

TREGUESI I LËNDËS PËR BULETININ ZYRTAR VËLLIMI 17, NUMËR 4,
QERSHOR 2015

1. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 39, datë 03.06.2015, "Për miratimin e dokumentit "Politika e auditimit të brendshëm në Bankën e Shqipërisë"
2. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 42, datë 03.06.2015, "Për disa ndryshime në rregulloren "Për ekspozimin e vlerave numizmatike dhe administrimin e ruajtjen e tyre nga Banka e Shqipërisë"
3. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 43, datë 03.06.2015, "Për disa ndryshime në rregulloren "Mbi regjimin e hyrje-daljeve dhe të lëvizjes në ambientet e Bankës së Shqipërisë, degëve dhe objekteve të saj"
4. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 44, datë 03.06.2015, "Për miratimin e emërimit të Drejtorit të Departamentit të Sistemeve të Pagesave dhe i Kontabilitetit dhe Financës të Bankës së Shqipërisë"
5. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 45, datë 03.06.2015, "Për miratimin e delegimit të kompetencës për nënshkrimin e marrëveshjes dhe gjithë dokumentacionit për saktësimin e kufijve të pronës së Bankës së Shqipërisë dhe asaj të ALBTELECOM"
6. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 46, datë 03.06.2015, "Për disa ndryshime në vendimin nr. 79, datë 31.10.2005, të Këshillit Mbikëqyrës "Për përcaktimin e strukturës organizative dhe numrin e punonjësve në organikë të Bankës së Shqipërisë" dhe në vendimet për organizimin e funksionimin e disa departamenteve të Bankës së Shqipërisë"
7. Licencë nr. 33, datë 26.06.2015, "Për të vepruar si institucion financiar i mikrokredisë në Republikën e Shqipërisë"

TREGUESI I LËNDËS PËR BULETININ ZYRTAR VËLLIMI 17, NUMËR 5,
GUSHT 2015

1. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 47, datë 1.07.2015, "Për mbajtjen e pandryshuar të normës së interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjella të riblerjes"
2. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 48, datë 1.07.2015, "Për miratimin e rregullores "Për kredinë konsumatore dhe kredinë hipotekare"
3. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 49, datë 1.07.2015, "Për disa ndryshime në rregulloren "Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit"
4. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 50, datë 1.07.2015, "Për disa ndryshime në rregulloren "Për administrimin e rrezikut nga ekspozimet e mëdha të bankave"
5. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 51, datë 1.07.2015, "Për dhënien e miratimit paraprak për kryerjen e veprimtarisë shtesë nga Banka Alpha Albania sh.a."
6. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 52, datë 1.07.2015, "Për rishtypjen e kartëmonedhave shqiptare me kurs ligjor, me prerje 200 lekë"
7. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 54, datë 6.08.2015, "Për mbajtjen e pandryshuar të normës së interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjella të riblerjes"

8. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 56, datë 6.08.2015, "Për miratimin e rregullore "Për veprimet me fondet në vlera monetare në Bankën e Shqipërisë"
9. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 57, datë 6.08.2015, "Për një ndryshim në rregulloren "Mbi asgjësimin e kartëmonedhave, monedhave metalike shqiptare dhe bonove të privatizimit"
10. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 58, datë 6.08.2015, "Për politikën e sigurisë së informacionit"
11. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 61, datë 6.08.2015, "Për një ndryshim në rregulloren "Mbi raportimet në Bankën e Shqipërisë sipas Sistemit Raportues të Unifikuar"
12. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 62, datë 6.08.2015, "Për dhënien e miratimit paraprak për kryerjen e veprimtarisë shtesë nga Banka Alpha Albania sh.a."
13. Vendim nr. 63, datë 6.08.2015, "Për miratimin e emërimit të Drejtorit të Departamentit të Sigurimit dhe Mbrojtjes së Bankës së Shqipërisë"

TREGUESI I LËNDËS PËR BULETININ ZYRTAR VËLLIMI 17, NUMËR 6,
SHTATOR 2015

1. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 66, datë 2.09.2015 "Për mbajtjen e pandryshuar të normës së interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjella të riblerjes"
2. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 67, datë 2.09.2015 "Për miratimin e rregullore "Për sistemin e kontrollit të brendshëm"
3. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 68, datë 2.09.2015 "Për disa ndryshime në Fondin Numizmatik të Bankës së Shqipërisë të miratuar me vendimin nr. 9, datë 6.02.2008, të Këshillit Mbikëqyrës, i ndryshuar"
4. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 69, datë 2.09.2015 "Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin "Mbi procedurat e shtypjes, të rishtypjes dhe të emetimit të monedhave metalike dhe kartëmonedhave për qëllime numizmatike, nga Banka e Shqipërisë"
5. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 70, datë 2.09.2015 "Për disa ndryshime në vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 78, datë 08.12.2004, "Për miratimin e kriterëve për caktimin e çmimeve të shitjes për kartëmonedhat dhe monedhat metalike, vlera të tjera numizmatike, ambalazhe dhe katalogë", si dhe të "Metodikës për llogaritjen e çmimeve të tyre"
6. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 71, datë 2.09.2015 "Për miratimin e rregullore "Për arkën numizmatike për shitje në Bankën e Shqipërisë"
7. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 72, datë 2.09.2015 "Për disa ndryshime në rregulloren "Për procedurat e blerjes së vlerave numizmatike në Bankën e Shqipërisë"
8. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 73, datë 7.10.2015 "Për dhënien e miratimit paraprak për zotërimin e 100 për qind të pjesëmarrjes influencuese në kapitalin aksioner të Bankës Credit Agricole Shqipëri"

- sha, nga Tranzit shpk"
9. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 75, datë 7.10.2015 "Për dhënien e miratimit paraprak për kryerjen e veprimtarisë shtesë nga Banka Kombëtare Tregtare sh.a."
 10. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 76, datë 7.10.2015 "Për miratimin e delegimit të kompetencës për nënshkrimin e aplikimit të Bankës së Shqipërisë në Programin për Harmonizimin e Vrojtiveve të Besimit Konsumator dhe të Biznesit të Komisionit Evropian"
 11. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 77, datë 7.10.2015 "Për miratimin e rregullores "Mbi organizimin dhe funksionimin e Komitetit të Investimit"
 12. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 78, datë 7.10.2015 "Për miratimin e delegimit të kompetencës për nënshkrimin e memorandumit të bashkëpunimit të Bankës së Shqipërisë dhe vendeve të rajonit me Autoritetin Bankar Evropian"

TREGUESI I LËNDËS PËR BULETININ ZYRTAR VËLLIMI 17, NUMËR 7,
NËNTOR 2015

1. Licencë nr. 34, datë 02.10.2015 "Për të vepruar si subjekt financiar jobankë në Republikën e Shqipërisë"
2. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 80, datë 4.11.2015 "Për uljen e normës së interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjella të riblerjes"
3. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 81, datë 4.11.2015 "Për miratimin e "Strategjisë afatmesme të zhvillimit të Bankës së Shqipërisë për periudhën 2016-2018"
4. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 82, datë 4.11.2015 "Për miratimin e rregullores "Për licencimin, rregullimin dhe mbikëqyrjen e operatorëve të sistemeve të pagesave dhe shtëpive të klerimit të pagesave"
5. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 83, datë 25.11.2015 "Për miratimin e rregullores "Mbi strukturën, kodifikimin dhe amortizimin e aktiveve të qëndrueshme në Bankën e Shqipërisë"
6. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 85, datë 25.11.2015 "Për disa ndryshime në rregulloren "Për nxjerrjen e vlerave materiale jashtë përdorimit" miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr.39, datë 26.05.2004"
7. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 86, datë 25.11.2015 "Për miratimin e mënyrës së shlyerjes së detyrimeve të Bankës së Shqipërisë ndaj qiradhënësve të ambienteve të marra me qira nga Banka e Shqipërisë sipas kontratave nr. 1085, datë 04.08.2014 dhe nr. 846, datë 20.06.2014"

Banka e Shqipërisë
Sheshi "Skënderbej", Nr.1, Tiranë
Tel: + 355 4 2419301/2/3; + 355 4 2419401/2/3
Faks: + 355 4 241 94 08
E-mail: public@bankofalbania.org
www.bankofalbania.org
Tirazhi: 350 kopje